REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "HOTELERI-TURIZËM"
TIRANË

Nr. 330 Prot.
Dt. 15.09.2025

PLANI VJETOR
2025-2026

Shtator 2025

Elona Qehajaj
Drejtore

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "HOTELERI TURIZËM"
TIRANË

K/Bordit
Fatos CERENISHTI
Fatos Cerenishti

1. Hyrje

Plani Vjetor 2025-2026 hartohet në kuadër të përcaktimeve të Udhëzimit NR. 759 i ndryshuar datë 30.09.2024 "PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL, SI DHE ASPEKTET E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE, PËRBËRJES SË NJËSISË SË ZHVILLIMIT TË OFRUESVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL DHE ZHVILLIMIT TË VAZHDUAR PROFESIONAL TË PERSONELIT".
Plani vjetor mbështetet në Strategjinë Kombëtare të Aftësimit dhe Punësimit 2023-2030.
Plani vjeor është një zbërthim i planit afatmesëm për vitin 2023-2027 për të përmbushur prioritetet, objektivat strategjikë të cilat janë mbështetur në analizën e jashtme, analizën e brendshme, analizën SËOT, rezultateve të vetëvlerësimit, prioriteve dhe objektivave strategjike të Strategjisë Kombëtare për Aftësi dhe Punësim 2023-2030.
Plani vjetor i punës së institucionit, hartohet me qëllim përmirësimin e rezultateve të cilësisë, të përgatitjes profesionale të nxënësve për tregun e punës, punësimit të tyre, përmirësimit të rezultateve të Maturës Shtetërore dhe marrjen e masave për përmirësimin e këtyre rezultateve. Qëllimi është përcaktimi i prioriteteve, hartimi i objektivave, planifikimi i veprimtarive dhe aktiviteteve për realizimin e objektivave dhe rezultateve cilësore të institucionit, duke përshtatur njëkohësisht objektivat me përmirësimin e treguesve cilësor dhe me kërkesat e tregut të punës, në zbatim të Planit Afatmesëm të institucionit.
Për të përmirësuar rezultatet dhe përgatitjen profesionale të nxënësve, po hartohet një plan i ri zhvillimi i institucionit i cili kërkon mbështetje edhe nga institucione qëndrore. Plani i zhvillimit synon përmirësimin e rezultateve të nxënësve në mësime, në Maturë Shtetërore si dhe në rritjen e numrin të nxënësve që përfundojnë studimet, të punësuar në tregun e punës.
Si bazë për një analizë të tillë vlerësuese kanë shërbyer, statistikat e institucionit, të Njësisë së Zhvillimit, rezultatet e Maturës Shtetërore, vëzhgimet e orëve mësimore, vëzhgimet e realizimit të praktikave në biznes si dhe raporti përfundimtar i vetëvlerësimit bashkë me rekomandimet përkatëse.
Shkolla ka prioritet gjithëpërfshirjen duke respektuar dallimet individuale, aftësitë e kufizuara dhe karakteristikat e tjera të ndryshme dhe efektet që ato kanë në zhvillimin dhe të nxënit. Njohja e parimeve dhe hulumtimet që lidhen me diversitetin te nxënësit, familjet, shkollat dhe komunitetet, duke përfshirë faktorët që lidhen me zhvillimin e nxënësit, me fenë, me kulturën dhe identitetin kulturor, me racën, me orientimin seksual, me identitetin dhe shprehjen gjinore, me statusin socio-ekonomik dhe me ndryshime të tjera janë në fokus të këtij plani, për arsim gjithpërfshirës.
Shërbimi psiko-social, në bashkëpunim me drejtuesit e shkollës, me stafin pedagogjik dhe me profesionistët e tjerë, marrin parasysh dallimet individuale, pikat e forta, prejardhjen, talentet dhe nevojat, në vlerësimin dhe në zbatimin e shërbimeve, në mënyrë që të përmirësojnë rezultatet e të nxënit, shëndetin mendor dhe sjelljen, për të gjithë nxënësit, në familje, në shkollë dhe në komunitet duke siguruar barazi gjinore dhe etnike si dhe arsim gjithpërfshirës. Shërbimi psiko-social do të punojë më shumë në lidhje me arsimin special dhe shërbimet e lidhura me to, për të promovuar praktika të specializuara mësimore dhe mbështetëse, që plotësojnë nevojat e ndryshme të nxënësve me aftësi të kufizuara duke u krijuar hapësirën dhe kushtet e nevojshme.

2. Procesi e përgjegjësitë

Plani vjetor i punës u hartua nga një grup pune i ngritur në shkollë me pjesëmarrjen e Njësisë zhvillimore, departamente, mësimdhënësve të kulturës së përgjithshme dhe kulturës profesionale si dhe me pjesëmarrjen e prindërve, nxënësve dhe anëtarëve të Bordit drejtues

Grupi për planifikimin dhe monitorimin

Elona Qehajaj	Drejtore
Fatbardha Sallaku	N/Drejtore
Donald Vogli	N/Drejtor
Alma Caka	Përgjegjëse Njësia e Zhvillimit
Edlira Dallo	Përgjegjëse e bazës prodhuese
Silva Gorica	Përgjegjëse e departamentit Hoteleri Turizëm
Rajmonda Gjana	Përgjegjëse e departamentit Hoteleri Turizëm
Liljana Gaba	Përgjegjëse e departamentit Teknologji Ushqimore
Esmeralda Meta	Përgjegjëse e ekipit lwndor të lëndëve të përgjithshme.
Eda Behaj	Sektori financë administrim

Hartimi i planit vjetor ishte një proces i gjatë konsultimesh me grupe interesi, analizash të dokumentacionit dhe rezultateve të një viti më parë si dhe analizë e kushteve aktuale të institucionit, infrastrukturës, buxhetit si dhe kushteve aktuale të tregut të punës dhe kërkesave të tij për punonjës të kualifikuar në profile të veçanta.
Gjithashtu vlen të theksohet se numri i prurjeve të reja për vitin shkollor 2025-2026 deri tani ka një ulje të lehtë në krahasim me vitin shkollor 2024-2025 por regjistrimet vazhdojnë deri nw 30 shtator 2025.

Hapat e ndjekur për hartimin e Planit Vjetor :

- ✓ Ndarja e detyrave mes grupit të punës;
- ✓ Grumbullimi evidencave brenda shkollës;
- ✓ Grumbullimi i evidencave për analizën e jashtme nga burime si INSTAT, Qarku Tiranë, Drejtoria Rajonale AKPA Tiranë;
- ✓ Takime e diskutime për hartimin e analizës së brëndshme,analizës së jashtme dhe analizës SËOT;
- ✓ Konsultimi më grupet e interesit si:këshilli i mësimdhënësve, qeveria e nxënësve, këshilli i prindërve, përfaqësues të bizneseve partnere;
- ✓ Reflektimi në plan i sugjerimeve nga konsultimi me grupet e interesit që konsiderohen me vlerë nga grupi i punës
- ✓ Plani Vjetor miratohet në Bordin e Shkollës

3. Analiza e gjendjes

Vitet e fundit, ministria përgjegjëse për AFP, i ka dhënë rëndësi të veçantë zhvillimeve në AFP duke patur në fokus CILËSINË dhe gjithëpërfshirjen.
Gjithashtu punësimi i nxënësve që gjatë viteve të shkollimit, krijon problematika me frekuentimin e shkollës nga nxënësit, sidomos në orët e fundit.

3.1 Analiza e mjedisit të jashtëm bardha

3.1.1. Zhvillimi ekonomik rajonal/turizmi dhe industria ushqimore

Tirana, si një kryeqytet turistik, ofron pothuajse të gjitha format e turizmit. Ajo që tërheq më shumë vëmendjen e turistëve është pjesa historisë, e komunizmit dhe muzetë.
Gjithashtu Tirana po kthehet edhe në një kryeqytet të gastronomisë, që ka një raport kualitet-çmim që nuk gjendet lehtë në vende të tjera. Kualiteti është rritur si në shërbim, ashtu dhe në cilësi. Tirana është qyteti që shquhet për mikpritjen dhe njerëzit shumë miqësor.
Turistët që vijnë për herë të parë në Shqipëri vlerësojnë kulturën, arkitekturën e Tiranës si dhe nga historinë e vendit tonë.
Tirana është pa dyshim një nga qytetet më të gjalla e më në shndërrim të Europës Juglindore. Ajo është kthyer në një qendër atraksioni turistik për turistë të huaj nga rajoni, Europa, por edhe më gjerë. Transformimi që po pëson Tirana po zë gjithashtu hapësira në revistat më të njohura të botës. Në Tiranë mund të shijosh pothuajse të gjitha format e turizmit, duke nisur nga ai kulturor, historik, duke vijuar te turizmi arkitekturor e kulinar, e mandej te turizmi malor dhe i aventurës.
Tirana e pozicionuar 15 km larg qendrës së Tiranës, krijon mundësi të arrihen lehtë atraksione kulturore, Kalaja e Petrelës, vendbanime antike, Kalaja e Dorëzit, Mali i Dajtit, lehtësisht i arritshëm, ku ka ushqim të mirë, ka hipizëm, vendpushime me kampera. Baldushku, Peza, Ndroqi, të gjitha këto rrethina që kanë nga një pikë të fortë. Kanionet e Erzenit janë gjithashtu pikë tjetër që frekuentohet shumë, pushuesit e shfrytëzojnë këtë zonë edhe për tu freskuar në ujin e lumit Erzen. Pra në pak kilometra gjen thuajse të gjitha format e turizmit.
Tirana ka rreth **56 objekte të trashëgimisë kulturore** dhe **141 pika turistike**. Tirana vitet e fundit ka hapur një sërë pikash turistike si Kulla e Sahatit e cila u rihap në Qershor 2016 pas rikonstruksionit të kryer, Shtëpia me gjethe, Bunkart1&2, rikonstruksioni i Sheshit, Pazarit, Kalasë edhe shumë pika të tjera për tu vizituar. Lonely Planet si dhe platforma të tjera dhe ëebsite turizmi, e përshkruajnë Tiranën si një vend intrigues, të këndshëm, me gjallëri dhe unik. Reliket e regjimit të vjetër sfidojnë ndërtimet e reja me ngjyra.
Statistikat më të fundit tregojnë se gjatë vitit 2024 kanë ardhur rreth 1 000 000 turistë të huaj më shumë se një vit më parë, prej të cilëve një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë vizituar edhe Tiranën, ku kanë shtuar ditët e qëndrimit në krahasim me vite më parë. Tirana, është një nga qytetet, që këtë sezon turistik, është vizituar më shumë nga të huajt. Për zhvillimin e madh të tregut turistik, Tiranës priten ti shtohen një numër i kosiderueshëm hotelesh Brand, për tiu përgjigjur më mirë kërkesave të turistëve.

Por jo vetëm turizmi ka një zhvillim cilësor në Tiranë. Përkrah kësaj industrie ecën me ritme të shpejta edhe zhvillimi i industrisë ushqimore. Në Tiranë dhe zonat përrreth saj, ka tashmë një numër të konsiderueshëm fabrikash dhe linja modern të prodhimit dhe përpunimit agroushqimor.

3.1.2 Tregues demografik dhe të tregut të punës

Bashkia e Tiranës kufizohet në veri me bashkitë Vorë, Kamëz dhe Krujë, në verilindje me bashkinë Klos, në lindje me bashkitë Bulqizë dhe Librazhd, në jug me bashkitë Elbasan dhe Peqin dhe në perëndim me bashkitë Rrogozhinë, Kavajë, Durrës dhe Shijak.

Të dhënat nga INSTAT tregojnë se më shumë se 1/3 e popullsisë jetojnë në qarkun e Tiranës. Krahas rritjes natyrore të popullsisë, faktor kryesor i rritjes demografike, është migrimi i brendshëm. Kjo ka bërë që numri i të rinjve në Tiranë të rritet me shpejtësi dhe kjo rritje është shoqëruar edhe me shtimin e kërkesave të tyre për të studjuar në shkollën tonë. Në zonën rurale të Tiranës jetojnë rreth 30 % e popullsisë dhe kjo shpjegon faktin që edhe një numër i konsiderueshëm nxënësish vijnë pikërisht nga këto zona.

Qarku i Tiranës përbën tregun më të madh të punës dhe ka nivel të ulët të papunësisë. Tirana ka popullsi relativisht të re në moshe dhe krijon mundësi të larta për arsimimin të rinjve. Pjesa me e madhe e universiteteve dhe shkollave profesionale ndodhen ne qarkun e Tiranës.

Kërkesat për fuqi punëtore në Tiranë, janë në shifra të larta. Kjo shpjegohet me faktin e zhvillimeve të mëdha që kanë ndodhur vitet e fundit në dy ekonomi të fuqishme siç është turizmi dhe industria ushqimore.

Statistikat nga Bashkia Tiranë tregojnë se:

Gjatë 2024, Bashkia e Tiranës e përbërë nga 24 njësitë administrative me një sipërfaqe [(1)] gjithsej prej 1,111 km2 ka:

- ✓ **Popullsi** Sipas të dhënave reflektohet se 32% e totalit prej 2.4 milionë banorësh, jetojnë në kryeqytet, Tiranë. Tirana mbetet qarku me më shumë banorë me 758 513,
- ✓ **Dendësi** popullsie prej 682 banorë/km2
  Mosha mesatare 37 vjeç
- ✓ **Gjinia**
  50.5% të popullsisë femra, ose raport gjinor prej 97.9 meshkuj për çdo 100 femra
- ✓ **Grupmosha**
  17.00% të popullsisë të rinj (0-14 vjeç)
  70.30% të popullsisë janë në moshë pune (15-64 vjeç)
  12.70% të popullsisë të moshuar (65 + vjeç)
  Rreth 46.07% të popullsisë nën 35 vjeç
  Rreth 24.58% të banorëve mbi 55 vjeç
- ✓ **Raport varësie moshore** prej 42.24% (24.18% për të rinjtë dhe 18.06% për të moshuarit). Në vend, Shqipëri, këto raporte janë 46.2% (24.6% për të rinjtë dhe 21.6% për të moshuarit) Ndërkohë në bashkinë e Tiranës 42.24% (22.97% për të rinjtë dhe 19.36% për të moshuarit).

- ✓ **Ndryshimi vjetor i popullsisë**
  Popullsi të shtuar gjatë vitit me 8,511 banorë ose e llogaritur ndryshe 23 banorë/ditë
  Popullsi të shtuar gjatë vitit me përafërisht 8 banorë/km
- ✓ **Shtesa natyrore, Lindje-**
  Në qarkun e Tiranës lindën 1750 foshnja në tremujorin e parë 2025 me rënie 18 % në krahasim me të njëjtën periudhe të një viti më parë.
  Shtim vjetor popullsie nga shtesa natyrore prej 1,264 banorë
  7,073 lindje ose 18 lindje për 1000 femra të grupmoshës 20-49 vjeç
  Raporti gjinor në lindje prej 106, kur Tirana e ka 106 nga 109 që është në vend
- ✓ **Bilanci i lëvizjeve, Të ardhur-Të larguar**
  Bashkia e Tiranës, më e madhja në vend, e cila është një qendër graviteti në krahasim me të tjerat për emigracionin e brendshëm, është shtuar vetëm me 40 mijë e 754 banorë nga 2011 në 2023.
- ✓ Shtim vjetor popullsie nga lëvizjet neto prej 5,187 banorë llogaritet si diferencë e të ardhurve me të larguarit nga gjendja civile për gjatë gjithë vitit.

- ✓ Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës 15+ 56,6
- ✓ Shkalla e papunësisë, popullsia 15+ 13,7
- ✓ Numri i ndërmarrjeve aktive / njësive vendore 5.4276 / 5.6743
- ✓ Paga mesatare mujore e personave të punësuar (Lekë) 60.857

3.1.3 Zhvillime politiko-ligjore

Vitet e fundit, ka një përmirësim të dukshëm të legjislacionit për AFP. Ministria përgjegjëse për AFP, ka miratuar një sërë aktet nënligjore, rregullore e dokumente të tjera që përmirësojnë punën e institucioneve arsimore. Gjithashtu dy agjencitë përgjegjëse për menaxhimin e shkollave të AFP dhe mbështjen me dokumente kurrikulare dhe trajnime mësimdhënësish, janë në riorganizim dhe shtim kapacitetesh dhe po mbështesin fort shkollat e AP.

Udhëzimit NR. 759 i ndryshuardatë 30.09.2024, rregullon veprimtarinë dhe funksionimin e institucioneve të arsimit profesional.

Gjithashtu Rregullore e Praktikave Profesionale, ligjëron dhe standartizon dokumentacionin e bashkëpunimit shkollë-biznes.

Në kuadër të procesit të akreditimit, vetëvlerësimi mbetet një komponent thelbësor për një sistem efikas të sigurimit të cilësisë që i paraprin akreditimit. Si hapi i parë drejt sigurimit të cilësisë, procesi i vetëvlerësimit , duhet të ketë përfunduar përpara se shkolla të nisë aplikimin për procesin e akreditimit në AKAFPK.

Ligji 15/2017 "PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË".

Ligji 69/2012 "PËR SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Ligji 56/2015 "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 69/2012 "PËR SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Ligji 10296, DATË 8.7.2010 "PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN", I NDRYSHUAR.

Ligji NR. 23/2018 "PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10 247, DATË 4.3.2010, "PËR KORNIZËN SHQIPTARE TË KUALIFIKIMEVE"".

Kodi i Procedurave Administrative te Republikës së Shqiperise

Ligj NR.8503, DATË 30.6.1999 "PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT PËR DOKUMENTET ZYRTARE"

Ligji NR. 9154, DATË 6.11.2002 "PËR ARKIVAT"

Ligji 15/2019 "PËR NXITJEN PËR PUNËSIM"

Urdhëri i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.128 datë 6.7.2021 "*Për miratimin e "Rregullores për Standartet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesëve të Arsimit dhe Formimit Profesiona*l"

Udhëzimit NR. 759 i ndryshuardatë 30.09.2025

Udhëzim NR. 28 DATË 30.07.2018 "MBI KRITERET PËR PJESËMARRJEN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E BORDIT DREJTUES TË OFRUESVE PUBLIKË TË ARSIMIT E FORMIMIT PROFESIONAL".

Vendim NR, 4, DATË 19.6.2017 PËR MIRATIMIN E "RREGULLORES SË NJEHSUAR TË PUNËS ME DOKUMENTET NË AUTORITETET PUBLIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Urdhër NR. 191, DATË 08.09.2016 "PËR NGRITJEN E SISTEMIT TË GJURMIMIT PËR NXËNËSIT E DIPLOMUAR DHE KURSANTËT E OFRUESVE PUBLIKË TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL"

Udhëzim NR.15, DATË 26.4.2019 PËR "ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROVIMEVE NË ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL"

Rregullore e PRAKTIKAVE PROFESIONALE NË BIZNES (U 220, DATE 16.09.2020)

Udhëzim NR 13 DATË 13.04.2022 PËR "MËSUESIN NDIHMËS DHE NGRITJEN E FUNKSIONIMIN E KOMISONIT PËR NXËNËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT PROFESIONAL. Udhëzim Nr 26,datë 22.09.2022 PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR .28 DATË 14.10.2029 "PËR NUMRIN E NXËNËSVE PËR KLASË DHE NORMAT E PUNËS MËSIMORE NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PROFESIONAL"

3.1.4 Nevojat për aftësi në rajon

Ndryshimet që ka pësuar ekonomia e vendit, në vitet e fundit, ka bërë që tregu i punës të transformohet dhe të ketë nevojë për fuqi punëtore me aftësi dhe kapacitete të ndryshme. Këto nevoja të tregut të punës nuk reflektohen sa dhe si duhet nga strukturat e arsimit profesional. Në zonat rurale ka nevojë për më shumë njerëz të kualifikuar me fokus në sektorët turizmit dhe të agroturizmit, por edhe në industrinë ushqimore. Numri aktual i nxënësve në shkollat profesionale pothuajse plotëson nevojat e tregut të punës, për fuqi punëtore sidomos sektori i hotelerisë. Këtë e vërtetoi fakti i kërkesave të mëdha për punonjës të këtij sektori gjatë sezonit turistik, por jo vetëm. Nevojat për punonjës të kualifikuar, e tejkalojnë rajonin ku vepron shkolla "Hoteleri-Turizëm", Tiranë. Strukturat hoteliere përgjatë bregdetit shqiptar, kanë kërkesa të mëdha për fuqi punëtore. Kërkesa të konsiderueshme ka patur gjithashtu edhe tregu turistik europian, të cilët i janë drejtuar shkollës, për ti ndihmuar në gjetjen e tyre, pikërisht me nxënës të diplomuar pranë shkollës sonë.

Punëkërkues të papunë të regjistruar në DRAKPA Tiranë



- Numri i NEET të regjistruar në DRAKPA Tiranë përbën 24% të totalit të të regjistruarve.
- Grupmosha 30-50 vjeç përbën 40% të totalit.
- Rreth 20% e totalit të të regjistruarve janë përfitues të ndihmës ekonomike

Subjektet partnere me shkollat dhe zyrën e punësimit

Aktiviteti Ekonomik	Shkolla Hoteleri - Turizëm	Shkolla Teknike Ekonomike	Shkolla Ndërtimit "Karl Gega"	Shkolle profesionale "Hermann Gmeiner"	Shkolla Teknike Elektrike "Gjergji Canco"	Shkolla Profesionale Bujqesore Kamëz	Shkolla e Mesme Kombëtare Agrobiznesit Golem "Charles Telford Erickson"	Biznese që janë klientë të DRAKPA	Total biznese aktive në qark	%
Bujqësia, Pyjet, Peshkimi						2	5	84	217	42%
Industria Nxjerrëse					2			76	419	19%
Industria Përpunuese	0	4	12		9		4	1781	3078	59%
Energjia elektrike, gaz, avull ajër i kondicionuar			34		30		1	152	430	50%
Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve					2			62	143	45%
Ndërtimi			5		12			1177	3597	33%
Tregtia me shumicë dhe me pakicë; Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave		1			93		6	4272	18554	24%
Transporti dhe magazinimi		17			3			547	2605	22%
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	112	5			2	36	23	2002	6186	35%
Informacioni dhe komunikacioni				57	48	19		830	3964	24%
Aktivitete financiare dhe të sigurimit		2			11		9	403	1785	24%
Aktivitete të pasurive të paluajtëshme								193	646	30%
Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike					20			911	3507	27%
Shërbime administrative dhe mbështetëse		1			1		2	667	690	97%
Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm		0					3	221	490	46%
Arsimi					1			312	550	57%

Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale						13		607	1902	33%
Arte, argëtim dhe çlodhje					1			120	523	23%
Aktivitete të tjera shërbimi		153	226	10	5	171	7	4458	12316	41%
Total	**112**	**183**	**277**	**67**	**240**	**241**	**60**	**18875**	**61602**	**33%**

- Niveli i mbulimit të bizneseve aktive në Tiranë nga institucionet e AFP dhe Zyra e Punësimit është në nivelin 33%.
- Rreth 57% e nxënësve të regjistruar në AP në klasat XI dhe XII të këtij qarku ndjekin praktikën në biznes.

Numri i nxënësve klasat e IX





Për vitin shkollor 2024- 2025:

- 27% e nxënësve të klasave të IX janë nga zonat rurale
- 32% e nxënësve në klasat e X të AP janë nga zonat rurale



Kërkesa dhe oferta e tregut të punës: *Punonjës të shitjeve dhe shërbimeve*



- Edhe pse nuk reflektohen VLP të shpallura në nënkategoritë profesionale Berber/ Parukier/ Estetist/ kujdestar për të moshuarit rezultatet pozitive të gjurmimit tregojnë se kjo kategori reflekton nevojat e tregut.

- VLP-të e shpallura identifikojnë nevojat e tregut të punës për specialist në:
  1- shërbime në bare dhe restorante
  2- shërbime shitje, për të cilat mund të ofrohen kurset e formimit profesional

3.2 Analiza e brendshme.

3.2.**1 Analiza e arritjeve të vitit të kaluar në kuadër të planit afatmesëm**.

Prioritet për shkollën "Hoteleri-Turizëm" Tiranë, janë realizimi cilësor i praktikave profesionale në biznes si dhe punësimi i nxënësve në tregun e punës, menjëherë pas përfundimit të shkollimit. Për këtë arsye, në shkollë për shumë vite me rradhë janë ofruar profile shumë të kërkuara nga tregu i punës si kuzhinier, kamarier, barist, recepsionist, punonjës në hotele dhe bujtina, bukëpjekës, pastiçier duke bërë përpjekje maksimale për plotësimin cilësor të nevojave të tregut.

Gjatë vitit shkollor 2024-2025 në shkollë u hapën dy kualifikime dual në drejtimin Hoteleri-Turizëm. Një sukses është edhe hapja e drejtimeve te sistemit VET by EHL

Ndër prioritetet e tjera mund të përmendim edhe shtimin e numrit të vajzave në shkollë për të rregulluar raportet djem-vajza dhe për t'i ofruar tregut punonjëse femra aq të kërkuara sot, sidomos në disa sektorë, siç është edhe sektori i mikpritjes, si dhe pranimi dhe përfshirja e të gjitha komuniteteve në shkollë.

Realizimi i objektivave të planit vjetor në kuadër të planit afatmesëm.

Prioritete	Objektiva afatmesme	Tregues performance	Statusi i realizimit
1.Oferta arsimore sipas kërkesës së tregut të punës që sigurojnë të nxënët gjatë gjithë jetës	1.1.1 Vlerësim periodik i nevojave të tregut	1.1.1.Numri i tryezave të dialogut të realizuara gjatë vitit shkollor 2024-2025 1.1.2 Numri i bizneseve pjesëmarrëse	Gjatë vitit shkollor 2024-2025 janë zhvilluar 2 tryeza dialogu me biznese të ndryshme në hotel "Hilton" të organizuara nga shkolla dhe Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimit (AKAFPK). Në këto tryeza u diskutuan disa çështje me rëndësi si: kurrikulat, punësimi, përgatitja e nxënësve, oraret e praktikave, fleksibiliteti i planit të praktikave të biznesit, etj. Numri i pjesëmarrësëve në këto tryeza ishte 15 biznese **Objektivi është realizuar plotësisht**
	1.2.1 Infrastrukturë bashkëkohore për të gjitha kualifikimet aktuale dhe të reja.	1.2.1 Numri i paisjeve/laboratoreve të reja	Përgjatë vitit shkollor 2024-2025 u realizua hapja e këtyre ambienteve te reja për realizimi e praktikave profesionale: Reparti për prodhimin e pijeve dhe Reparti për përpunimin e fruta - perimeve.

			Laboratori i gjuhëve të huaja Laboratori i TIK-ut për kualifikimin EHL Dhoma e hotelit për kualifikimin EHL Gjithashtu është mundësuar edhe mirëmbajtja dhe pasurimi i laboratorëve ekzistues. **Objektivi është realizuar në masën 100%**
	1.3.1 Ritje profesionlae e mësimdhënësve nga shkolla dhe biznesi	1.3.1 Të gjithë mësimdhënësit që japin mësim në kualifikimet të trajnohen nga shkolla dhe biznesi	Janë realizuar trajnime të brendshme të stafit nga mësimdhënës të trajnuar me tematika të ndryshme. Janë realizuar orë të hapura brenda departamenteve me qëllim shkëmbim përvoje. Janë realizuar trajnime profesionale nga biznesi. Bazuar në dokumentacionin e ZH.V.P në database e mësimdhënësve rezulton se të gjithë mësimdhënësit kanë realizuar trajnimin e bazat e didaktikës. **Objektivi është realizuar në masën 100%**
2.Përmirësimi i të nxënit në vendin e punës	2.1.1. Realizimi i praktikat në biznes sipas udhëzimit të praktikave në të dy drejtimet.	2.1.1. Realizimi i praktikave në biznes 100% sipas udhëzimit në drejtimin mësimor "Hoteleri-Turizëm" dhe "Përpunim Brumi"	Bazuar në dokumentacionin e koordinatorit të biznesit rezulton që për vitin shkollor 2024-2025 praktikat në biznes në drejtimin mësimor "Hoteleri- Turizëm" dhe "Teknologji ushqimore" janë realizuar 95% në rang shkolle.Të gjitha profilet 100%, Jo të gjithë klasat e XIII kanë zhvilluar praktikë në biznes **Objektivi është realizuar afërsisht në masën 100%**
	2.1.2 Realizimi i praktikave në bisnes për të gjithë kualifikimet e sistemit EHL	2.1.2 Realizimi në masën 100 % praktika 12 javore për të gjithë kualifikimet e sistemit EHL	Bazuar në dokumentacionin e koordinatorit të biznesit rezulton që për vitin shkollor 2024-2025 praktika 12 javore për të gjithë kualifikimet e sistemit EHL është realizuar në masën 100 %. Bbizneset ku janë zhvillaar këto praktika janë, Fafa resort,hotel Hilton Garden Inn,Melia, Mariot etj **Objektivi është realizuar plotësisht**
	2. .1.3 Ritja e numrit të nxënësve të punësuar në tregun e punës me	2.1.3 Përqindja e nxënësve të punësuar kundrejt totali.	Bazuar në rezultatet e gjurmimit të ish nxënësve tanë për vitin shkollor 2023 – 2024 numri i nxënësve të punësuar është 61% krahasuar me numrin e ish nxënësve të punësuar për vitin shkollor 2022 – 2023 që ishte 45% kundrejt totalit.

	5% më shumë krahasuar me një vit më parë.		**Objektivi është realizuar në masën 100%**
	2.2.1 Përfshirja në kurrikulën në bazë shkolle e "Aftësive të Buta, digjitale dhe të gjelbëra."	2.2.1 Të gjitha kurrikulat e hartuara në shkollë për kulturën profesionale kanë të përfshirë edhe "Aftësitë e Buta, digjitale dhe të gjelbra"	Bazuar në rezultatet e kontrolleve të dokumentacioneve nga drejtoria, rezulton se në kurrikulat shkollore për kulturën profesionale, janë të përfshirë, përveç të tjerave edhe "Aftësitë e Buta, digjitale dhe të gjelbra". **Objektivi është realizuar plotësisht**
	2.3.1 Ngritja e strukturave të brëndshme për monitorimin dhe garantimin e cilësisë	2.3.1 Të gjithë anëtarët e strukturave të brëndshme kapacitohen për monitorimin dhe garantimin e cilësisë	Bazuar në kontrollet e monitorimit të drejtorisë rezulton se të gjithë anëtarët e strukturave të brendshme të shkollës, janë përfshirë në mënyrë aktive në procesin e trajnimit dhe mbështetjes, duke fituar aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të ushtruar me efektivitet rolin e tyre në monitorimin e vazhdueshëm dhe në përmirësimin e cilësisë së proceseve mësimore dhe edukative. **Objektivi është realizuar plotësisht**
3.Mësimdhëni e inovative	3.1.1Përmirësimi i cilësia e mësimdhënies duke përdorur metoda bashkëkohore dhe teknologji digjitale në mësimdhënie	3.1.1.Përqindja e mësimdhënësve që përdorin teknologji digjitale në mësimdhënie.	Bazuar në kontrollet tematike të drejtorisë së shkollës, në realizimin e orëve të hapura në departamente, rezulton se ka një rritje të përdorimit të teknologjisë digjitale në mësimdhënie nga mësimdhënësit e lëndëve/moduleve të ndryshme . **Objektivi është realizuar plotësisht**
	3.1.2 Kapacitimi i të gjithë mësimdhënësve për pedagogjinë digjitale për përdorimin e materialeve mësimore digjitale	3.1.2 Përqindja e mësimdhënësve që përdorin materiale mësimore digjitale	Gjatë vitit shkollor 2024-2025 mësimdhënësit kanë përdorur teknologji digjitale, kanë përdorur materiale mësimore digjitale nga platforma mesovet.al. Mësimdhënësit e kulturës së përgjithëshme në laboratorët TIK kanë punuar me nxënësit e klasave të 10 për provimin PISA në platfrmën e provimit PISA Nxënësit e sistemit VETby EHL kanë përdorur 100% në lëndët profesionale teknologji digjitale dhe jo vetëm, teknologjia digjitale është përdorur edhe në vlerësim sipas standardeve të sistemit VET by EHL Si pasoje e shtimit të paisjeve, projektorëve shumeë orë mësimore janë realizuar në mënyrë digjitale.

			Objektivi është realizuar plotësisht
	3.2.1 Përditësimi i kurrikulës shkollore sipas udhësumeve të fillim vitit dhe bazës ligjore në fuqi	3.2.1 Të gjitha planet lëndore dhe programet e moduleve të praktikave profesionale rishikohen duke përfshirë përdorimin e teknologjisë DIGJITALE dhe metodat inovative të mësimdhënies	Bazuar në kontrollet e planeve lëndore dhe programet e moduleve të praktikave profesionale të realizuara nga drejtoria, konstatohet se në këto plane dhe programe, janë përfshirë përdorimi i teknologjisë DIGJITALE dhe metodat inovative të mësimdhënies. **Objektivi është realizuar plotësisht**

OBJEKTIVAT E PLANIT VJETOR 2024-2025 JANË REALIZUAR 100%

3.2.2 Performanca e nxënësve në tregun e punës.



Sipas grafikut kemi këto rezultate nga gjurmimi i nxënësve realizuar në janar shkurt 2025 për maturantët e vitit shkollor 2023-2024. Universitet 16 %, punë 61 %, punë dhe universitet 8 %, emigrim 8%, pa punë ose në pritje të një pune 38 %, nuk u përgjigjën 7%.

3.2.3 Nxënës nga regjistriminë diplomim

Klasa	Nxenes Shtator		Larguar		Nxenes ne Qersh		Kaluan ne Qershor		Kalueshmeria %	Nota Mesatare
	Gj	Fem	Gj	Fem	Gj	Fem	Gj	Fem	%	
X Teknologji ushqimore	24	7	3	0	21	7	21	7	100 %	6.1
X Hoteleri – Turizëm	176	37	11	4	163	33	145	33	89 %	6.1
X EHL Hoteleri	25	9	1	0	24	9	24	9	100 %	7.7
X EHL Kuzhinë	25	8	1	0	24	8	24	8	100 %	7
X EHL Shërbime Ushqim & Pije	15	4	0	0	15	4	15	4	100 %	7.1
XI- Teknologji ushqimore	20	7	3	0	17	7	17	7	100 %	6.3
XI- Hoteleri - Turizëm	179	30	6	1	172	29	153	25	89 %	6.2
XII- Teknologji ushqimore	17	6	1	1	16	5	13	5	81 %	7.4
XII Hoteleri - Turizëm	131	31	2	1	129	30	119	30	92 %	6.6
XIII- Teknologji ushqimore	33	3	0	0	33	3	27	3	82 %	5.9
XIII Hoteleri - Turizëm	101	25	1	0	100	25	93	25	97 %	6.4
TOTAL NË QERSHOR	**746**	**168**	**29**	**7**	**716**	**161**	**653**	**156**	**92 %**	**6.4**

Nga analiza e regjistrimeve dhe largimeve rezulton që janë regjistruar 746 nxënës nga këta 265 në klasën e dhjetë,pra për herë të parë. Vajza të regjistruara janë 168 dhe nga këto 65 për herë të parë.

Sipas drejtimeve:

1. Drejtimi Hoteleri – Turizëm për herë të parë janë regjistruar 176 nxënës nga këta 37 janë vajza.
2. Vet by EHL për herë të parë në të tre drejtimet janë regjistruar 65 nxënës nga këta 21 janë vajza.
3. Drejtimi Teknologji Ushqimore janë regjistruar 24 nxënës nga këta 7 janë vajza.

Numri i nxënësve të larguar në shkollën Hoteleri – Turizëm është 29 nxënës nga cilët 6 janë vajza. Numri më i madh i largimeve rezulton në klasën e dhjetë, drejtimi Hoteleri – Turizëm, ndërkohë largime ka edhe nga drejtimi Teknologji Ushqimore ku nga një

klasë me 24 nxënës janë larguar 3 nxënës.

Kalueshmëria në qershor si shkollë është 92% me notë mesatare 6.4. Kalueshmëria më e vogël është në drejtimin Teknologji Ushqimore klasa XII-1.

PAS PROVIMEVE TË VJESHTËS JANË KËTO REZULTATE.



Pas provimeve të vjeshtës nga analiza e tabelës rezulton se shkolla ka një kalueshmëri 100 % dhe notë mësatare 6.6 për vitin 2024 - 2025. Dhe për vitin 2023 - 2024 ka kalueshmëria e përgjithshme: 99 dhe notë mesatare: 5.8 duke e krahasur me një vit më parë rezulron se ka një rritje me 1 % në kalueshmëri ndërsa nota mesatare ka ndryshuar me 0.8

Pasqyra e frekuentimit

Klasat sipas viteve	M.A.	M.P.A	M.GJ.	1-3	1-3 %	Nx. nxënësve	Mungesa/ nxënës	Paralajmërim	Përjashtuar	Larguar	Të ardhur
klasa X	1341	2040	3381	1890	56%	249	13.6	16	2	14	4
klasa XI	3739	2220	5959	1736	29%	189	31.5	8	2	10	
klasa XII	873	1572	2445	1502	61%	145	16.9	11	1	2	
klasa XIII	591	1589	2180	1534	70%	133	16.4	11	0	1	
Shkolla total	**6544**	**7421**	**13965**	**6662**	**48%**	**716**	**19.5**	**46**	**5**	**27**	**4**

Numri mungesave për nxënës për vitin shkollor 2024-2025 është 19.5, duke e krahësuar me vitin shkollor 2023- 2024 ku numri i mungesave për nxënës ishte 18.6 ka një rritje me 0.9 mungesa për nxënës.


CERTIFIKATAT E NIVELIT TË III-të SIPAS PROFILIT 2024-2025
100%
90%
80%
70%
60%
50%
40%
30%
20%
10%
0%
1
2
SHKOLLA
7.2
5
16
5
16
7.2
5
16
5
16
6.9
8
30
8
30
7.4
4
21
4
21
7.6
9
14
9
14
6.8
2
30
2
30
6.6
7
34
7
34
7.1
30
129
30
129
7.1
35
145
35
145
Dega
Profili
Nxenes Qershor Gj
Nxenes Qershor F
Certifikuar Qershor + Vjeshte Gj
Certifikuar Qershor + Vjeshte F
Certifikuar Qershor + Vjeshte N/Mesat

Rezultatet e provimeve të nivelit.



Nga të dhenat më lart rezulton që kalueshmeria është 100% në të gjitha klasat për nivelin e dyte në Teorinë Profesionale ndërsa nota mesatare: XI-1 me notë mesatare 6.7 dhe nota mesatare e Praktikës Profesionale është 6.9 kaq është edhe për të gjithë drejtimin sepse ka vetëm një klasë. Në drejtimin Hoteleri - Turizëm janë këto nota mesatare për Teorinë Profesionale: XI-2 nota mesatare 6.8, XI-3 nota mesatare 6.7, XI-4 nota mesatare 7.8, XI-5 nota mesatare 6.4, XI-6 nota mesatare 7.2 dhe XI-7 nota mesatare: 7. Ndërsa në Praktikën Profesionale, kalueshmëria në të dy drejtimet është 100%. Nota mesatare në të dy drejtimet është 6.9.

Rezultatet në provimeve të nivelit klasat 12 niveli III në KSHK



Kalueshmëria në dy drejtimet Hoteleri – Turizëm dhe Teknologji Ushqimore ka qenë 100 % si për Teorinë Profesionale ashtu dhe për Praktikën Profesionale. Nota mesatare në drejtimin Hoteleri– Turizëm ka qenë 6.6 për Teorinë Profesionale dhe 7.5 për Praktikën Profesionale. Nota mesatare në drejtimin Teknologji Ushqimore ka qenë 5.9 për Teorinë Profesionale dhe 8.5 për Praktikën Profesionale.

Rezultatet e nivelit të IV në KSHK



Kalueshmëria në dy drejtimet Hoteleri – Turizëm dhe Teknologji Ushqimore ka qenë 100 % për Praktikën Profesionale. Nota mesatare për drejtimin Teknologji Ushqimore, përkatësisht XIII-1 ka qenë 5.8 ndërsa drejtimi Hoteleri - Turizëm: XIII-2 nota mesatare 7.1, XIII-3 nota mesatare 6.6, XIII-4 nota mesatare 6.5, XIII-5 nota mesatare 7.2. Nota mesatare në drejtimin Hoteleri – Turizëm është 7.

Rezultatet e Maturës Shtetërore.

Numri i maturantëve	Maturantë mbetës	Maturantë në qershor			
133	13	Gjuhë	Matematikë	Anglisht	Z1
Maturantë në provim		120	120	120	120
U paraqitën		120	120	120	120
Nota mesatare		5.5	5.8	6.9	7
Kalueshmëria		98.3 %	100 %	97.5%	100%

Sezoni i dytë i Maturës Shtetërore.

		Gjuhë	Matematikë	Anglisht	Z1
Maturantë në provim		16	13	16	13
U paraqitën		14	12	15	10
Nota mesatare		5.1	5.2	6.5	6.2
Kalueshmëria		97%	100%	100%	100%



Rezultatet e këtij viti shkollor për maturantët tregojnë një sukses të dukshëm dhe një përqindje më të lartë kalueshmërie, çka reflekton seriozitetin e përgatitjes dhe punës së bërë si nga nxënësit ashtu edhe nga stafi pedagogjik.

Kalueshmëria

Nga 133 maturantë, 120 e përfunduan maturën me sukses që në sesionin e qershorit, duke arritur një kalueshmëri mesatare mbi 97% në të gjitha lëndët.

Pjesa e mbetur (13 maturantë) arriti të përmbyllë provimet në sesionin e dytë, duke rritur edhe më shumë nivelin e përgjithshëm të kalueshmërisë.

Gjatë vitit shkollor, është hartuar grafik konsultimesh për çdo lëndë dhe mësimdhënësit kanë qenë të angazhuar totalisht për të realizuar me sukses procesin e konsultimeve. Megjithë angazhimin e stafit, interesi për konsultime ka qenë më i madh në matematikë, por jo në lëndët e tjera.

Gjatë gjithë vitit shkollor, drejtoria e shkollës është kujdesur që rezultatet në provimet përfundimtare të Maturës Shtetërore të ishin sa më pozitive. Si pjesë e kalendarit të testimeve që drejtoria organizon çdo vit shkollor, ka qenë edhe testet paraprake për maturantët në lëndët e Maturës Shtetërore.

Testet e drejtorisë të zhvilluaa gjatë vitit shkollor

Testet e drejtorisë të zhilluara në klasat e X (teste për të matur njohuritë nga shkolla 9–vjeçare) të zhvilluara në lëndët *Fizikë* dhe Matematikë

Rezultatet e testimit *Fizikë:*

Klasat 10	Nx. Gjithsej	Prezent në testim	Kalueshmëria	Nota mesatar e
Gjithsej	85	76	40 %	4. 5

Rezultatet e testimit *Matematikë:*

Klasat 10	Nx. Gjithsej	Prezent në testim	Kalueshmëria	Nota mesatar e
Gjithsej	51	43	100%	4. 0

Siç shihet nga rezultatet e testeve, notat e marra në shkollat 9-vjeçare nuk përkojnë me nivelin e njohurive në test. Nxënësit kanë mangësi në njohjen e koncepteve bazë.

Testet e drejtorisë të zhilluara në disa nga klasat e XI, XII, XIII në lëndët e kulturës së përgjithëshme.

Lëndët	Klasa	Nx. Gjithsej	Prezent në testim	Kalueshmëria	Nota mesatare
Gjuhë	XI - 1,2	51	43	100%	5. 5
Anglisht	XI - 2	28	24	100%	6.1
Histori	XI- 4	29	25	92 %	6.3
Matematikë	XI – 5	29	25	52%	4.5
Kimi	XI - 6	30	28	82%	5
Gjermanisht	XI – 3	30	28	86%	5.1
Matematikë	XII - 4	14	14	57%	4.6
Anglisht	XII - 3	21	21	100%	6.8
Biologji	XIII -1	33	22	64%	5.1
Filozofi	XIII – 3	27	25	100%	6.9
Gjeografi	XIII - 5	27	22	100%	7.1

Testet e drejtorisë të zhilluara në disa nga klasat e XI, XII, XIII në lëndët e kulturës profesionale

Nr	Lëndët Profesionale	Klasa	Nxënës Gjithsej	Morën pjesë në provim	Nota Mesatare	Kalueshmëria %
1	Mikrobiologji Ushqimore	X-1	21	21	5.6	100%
2	Teknologji Ushqimore dhe Ftohje	X-1	21	21	6.2	100%
3	Ushqim dhe Pije	X-10	30	28	5.5	96%
4	Teknologji Ushqimore dhe Ftohje	XI-1	17	15	6.7	100%
5	Kimi Organike dhe Ushqimore	XI-1	17	15	6.4	100%
6	Proc, aparate dhe paisje të Tek.Ushq	XI-1	17	15	6.3	100%
7	Turizmi dhe Mjedisi	XI-3	30	27	5.1	90%
8	Ushqim dhe Pije	XI-4	29	26	6.6	100%
9	Teknologjia e përpunimit të brumrave	XII-1	16	16	5.6	100%
10	Bazat e Sipërmarrjes	XII-2	30	28	5.2	92%
11	Teoria e të Ushqyerit	XII-6	35	31	6.2	88%
12	Org. dhe Ligjsh. Në Tek.Ushqimore	XIII-1	33	32	5.8	93%
13	Kontr i Sigur dhe Ciles tek Ushq	XIII-1	33	30	5.83	93%
14	Mjedis dhe zhvillim i qëndrueshëm	XIII-2	24	15	7.3	100%
15	Bazat e Sipërmarrjes	XIII-3	27	27	5.5	96%
16	Kontabilitet	XIII-5	27	27	6.5	100%
Totali			**407**	**374**	**6.0**	**96.7**

Nr	Lëndët Profesionale		Klasa	Nxënës Gjithsej	Morën pjesë në provim	Nota Mes	Kal %
1	Gjeografi Turistike		XIII-3	29	21	6,5	100
2	Ekonomi Turizmi		XIII-4	22	17	5,8	88
3	Komunikimi në gjuhën angleze		XII-4	14	14	7,1	100
4	Shërbime në bar dhe restorant		XII-5	30	25	7	83
5	Teoria e shërbimeve hoteliere		XII-6	35	30	6	96
6	Organizimi i strukturave hoteliere dhe gastronomike		X-9	28	28	6,2	100
7	Trashëgimi Kulturore		X1-2	28	22	5,2	91
				186	**157**	**6,2**	**94%**

- përfundimit dhe analizës së zhvilluar mes drejtorisë dhe mësuesëve të lëndëve u diskutua dhe më pas u hartuan planet e përmirësimit nga secili mësues.

Puna për realizimin e testit PISA

Gjatë këtij viti shkollor është realizuar një punë intensive mbi përgtitjen e nxënësve për testin PISA (periudha dhjetor – prill) .

- Në përgatitjet për testin Pisa përfshihen:

  - Zhvillimi i testit diagnostikues në muajin dhjetor në të gjitha lëndët nga secili mësues dhe më pas hartimi i planit të punës dhe përmirësimit në bazë të mangësive që u vunë re.
  - Zhvillimi i tre testeve simuluese model Pisa të krijuar nga ekipi i Pisës i zhvilluar në platformën Google form.

- -Analizimi i rezultateve të testeve simuluese me qëllim evidentimin e mangësive dhe përqëndrimin e punës në vazhdim për përmirësimin e tyre.
- -Konsultimet sipas grafikut të përcaktuar nga drejtoria e shkollës si dhe puna në dhjetë minutëshin e fundit të çdo ore mësimore.
- -Konsultimet e zhvilluara në orët e T.I.K-ut sidomos në periudhën e fundit ku u përcaktuan nxënësit pjesëmarrës në test.

Përbërja sociale e shkollës: 2024-2025	
Numri i nxënësve sipas grupeve sociale	**Totali**
Numri i nxënësve gjithsej	740
Nunri i vajzave	171
Me prindër të divorcuar	43
Jetim me status	6
Me një prind të vdekur	33
Nxënës përsëritës	11
Me tendencë droge/duhan	54
Të komuniterit egjyptian	19
Të komunitetit rom	5
Me nivel të shumë të ulët ekonomik	46
Të rinj të ardhur nga shkolla të tjera	4
Të talentuar	10
Nxënës me probleme shëndetësore.	11
Nxënës me nënshtetësi të huaj.	3
Me përkujdesje institucionale	4
Aftësi e kufizuar	13
Konviktor	15
Zona urbane/ rurale	588/ 153
Jashtë qarkut	52
Me qera	85

Numri më i madh i nxënësve që studiojnë aktualisht vjen nga Tirana dhe rrethinat e saj, por edhe nga qytete të tjera. Kryesisht janë nxënës që vijnë nga familje me të ardhura të pakta ekonomike.

*3.2.4 **Stafi drejtues, mësimor e mbështetës***

Institucioni ka në organikë 75 punonjës, nga të cilët 59 mësimdhënës dhe 16 personel mbështetës.

Drejtues gjithsej: 4
Drejtues 1
N/Drejtorë: 2
Përgjegjës Bazë Prodhuese: 1

Drejtuesi i institucionit është i komanduar që në dhjetor 2024 e në vazhdim, ka qenë nëndrejtore e lëndëve të përgjithshme. Shkolla ka dy nëndrejtorë të kulturës profesionale të emëruar gjatë vitit shkollor 2024-2025 të cilët kanë qenë mësimdhënës në shkollë. Përgjegjësja e bazës prodhuese është emeruar në këtë detyrë prej vitit 2009

Stafi mësimdhënës

Stafi mësimdhënës:	59 mësimdhënës
➢ Mësimdhënës të lëndës së përgjithshme	24 mësimdhënës
➢ Mësimdhënës të lëndëve profesionale	13 mësimdhënës
➢ Mësimdhënës të praktikës profesionale	22 mësimdhënës
Stafi mbështetës :	16

Pothuajse të gjithë mësimdhënësit e Kulturës Profesionale janë të trajnuar gjatë viteve të punës si mësimdhënës në shkollë, nga projekti austriak K-Kontakt /OeAD, Parsh, GTZ, ETF si dhe projekte të tjera të huaja. Ato janë trajnere, autore materialesh mësimore dhe tekstesh për nxënësit, anëtare të grupeve të punës për hartimin e dokumenteve kurrikularë, ndërsa mësimdhënësit e tjerë janë në proces trajnimi të vazhdueshëm.
Mësimdhënësit e moduleve profesionale vijnë nga përvoja të gjata pune në biznes dhe shumë prej tyre kanë qenë edhe ish nxënës pranë shkollës. Ata zotërojnë aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe janë shumë të angazhuar në trajnimin profesional të nxënësve.

Në shkollë mësimdhënësit e teorisë profesionale janë kryesisht mësimdhënës me përvojë të gjatë pune, por për shkak të rritjes së numrit të nxënësve në shkollë dhe hapjes së profileve të reja, numri i mësimdhënësve të rinj, është rritur. Departamentet lëndore dhe drejtoria e shkollës ka bërë përpjekje për trajnimin profesional të tyre me trajnime të brendshme por edhe me ekspertë të jashtëm. 97% e stafit që vijnë nga universitete jo mësimdhënësie, kanë kryer trajnimin didaktik 24-30 ditor.
Gjithashtu ka patur përpjekje edhe për vetëtrajnime, duke ndjekur trajnime që ofrohen nga organizata të akredituara. Ka mësimdhënës të cilët vazhdimisht ndjekin edhe trajnime në nivel europian dhe certifikohen për trajnimet e kryera.
Mësimdhënësit e kulturës së përgjithme vijnë të gjithë nga Universitete të mësuesisë, ata përgjithësisht zotërojnë konceptet shkencore të lëndës dhe janë aktivë në orët e mësimit, duke konsideruar nivelin e arritjeve të nxënësve tanë. Janë hartues të mire të planeve lëndore, të planeve ditore dhe janë trajnuar nga institucioni edhe për mënyrat e vlerësimit në Kulturën e Përgjithshme.
Mësimdhënësit përgatiten rregullisht me Plane Ditore, ku përshkruhen me detaje të gjitha fazat e orës mësimore. Çdo ditë përgatitja ditore e tyre mund të monitorohet nga drejtuesit e shkollës, pasi ajo dërgohet me E-Mailin zyrtar të institucionit, të paktën prej tre vitesh. Ka modele të përgatitjes së tyre dhe performancës në mësimdhënie për tu ndjekur nga të gjithë mësimdhënësit e rinj, apo mësimdhënësit që nuk kanë të njëjtën performancë.
Gjatë vitit shkollor 2024-2025, nuk janë realizua trajnime me buxhetin e institucionit me kredite

Personeli mbështetës:

Sektori financës zotëron aftësitë për të monitoruar, kontrolluar dhe zbatuar të gjitha ligjet, udhëzimet dhe urdhërat që jepen nga institucionet qëndrore për menaxhimin financiar.
Sekretaria është drejtuar me shumë kompetencë, duke zbatuar me përpikmëri të gjitha afatet kohore për hedhjen në Amëz të rezultateve vjetore, të Maturës Shtetërore apo rezultatet e Sesionit të II. Amzat e shkollës që janë dokumenti më i rëndësishëm, janë plotësuar vetëm nga sekretaria mësimore e institucionit. Sekretaria ka lëshuar dokumente zyrtare për të gjithë të interesuarit në afate kohore dhe pa asnjë gabim. Dokumentacioni shkollor ruhet në kushte të mira fizike dhe kushte sigurie.

Shërbimi psikosocial ka 1 psikolog të emeruar këtë vit ka zëvendësuar ish psikologen. Shërbimi psikologjik ka qenë aktiv, duke evidentuar rastet që kërjonë mbështetje dhe ndërhyrje, dukëe punuar me rastet, me mësimdhënësit kujdestarë të tyre si dhe duke komunikuar dhe u konsultuar vazhdimisht me prindërit.
Specialist TIK 1 i enëruar këtë vit
Shërbimi i rojeve kryen me korrektësi dhe kompetencë detyrat e tij dhe raporton rregullisht për çdo problematikë që ka lidhje me sigurinë në institucion.
Mirëmbajtësi ka garantuar maksimalisht kushtet e mirëfunksionimit të institucionit dhe veçanërisht të reparteve të praktikave profesionale, ku puna e tij është shumë e rëndësishme.
Shërbimi i pastrimit ka kryer shumë mirë detyrat e përcaktuara edhe në kushtet e zhvillimit të mësimit në dy godina dhe me shumë turne.

3.2.5 Infrastruktura

a) Të dhëna të përgjithshme

Godina e shkollës është ndërtuar në vitin 1959 dhe është rikonstruktuar pjesërisht në vitin 2007 – 2009. Në vitin 2019, shkollës i janë shtuar dy godina të reja, me 10 - klasa mësimore dhe disa reparte të praktikave profesionale, investime të qeverisë shqiptare. Godina ka tri kate, ku në katin e dytë dhe të parë janë të vendosura laboratoret, FU, laborator TIK, kabinetet profesionale, biblioteka e shkollës, dhoma e qeverisë së nxënësve, dhoma e psikologes, biblioteka, salla e konferencave, zyra të administratës, reparte të praktikave profesionale, palestra etj. Në këto ambjente aktualisht zhvillohet mësim normalisht. Godina është rikonstruktuar vitet e fundit dhe ka dyer e dritare të reja,

Godina e shkollës ka 32 klasa mësimore, 18 dhoma mësimore, 1 laborator biologjie, 1 laborator kimie, 1 laborator fizike, 1 laborator të kryerjes së analizave të produkteve ushqimore, 2 laborator TIK, 2 zyra mësimore, 2 recepsion, 3 restorante dhe 1 bar (në funksion të procesit mësimor), 5 kuzhina (në shërbim të procesit mësimor), 1 laborator i gjuhëve të huaja, 2 dhoma hoteli, i dhome për nxënës me AK, 1 palestër, terren sportiv dhe anekse të tjera funksionale (magazinë, arkivë etj).

Godina është e pajisur me sistem ngrohje.

Në oborrin e jashtëm funksionon **Baza Prodhuese** me disa reparte të praktive profesionale:

3 Kuzhina
1 Restorant
1 Bar
1 Lavanteri
3 Dhoma Zhveshje
1 Repart Prodhim pijesh dhe përpunim fruta perime.
1 Repart Qumështi (i montuar pjesërisht
1 Repart Përpunim Brumi

Godina dhe oborri i saj kanë ndriçim të bollshëm.

Shkolla ofron ambjente shlodhese dhe të gjelbëruara rreth saj me lule dhe të kuruara estetikisht.

- ✓ Psikologia e shkollës e realizon veprimtarinë e saj në zyrën e psikologes (këshillim dhe realizim të aktiviteteve të tjera).
- ✓ Shkolla ofron infrastrukturën e duhur për fëmijë me aftësi të kufizuar.
- ✓ Shkolla ka bashkëpunime të vazhdueshme me organizata të tjera, donatorë të huaj që mbështesin AP në Shqipëri, qendra trajnimesh profesionale, organizata kulturore, sportive dhe artistike si dhe është e hapur për bashkëpunime të reja. Eshtë anëtare e AEHT, Shoqata e shkollave Europiane të Hotelerisë. Në vitin 2019-2020 është bërë pjesë e rrjetit të shkollës së ekselencës për të nxënët në vendin e punës dhe aktualisht është anëtare e këtij rrjeti europian – ETF.

Sisteme TIK që përdoren dhe aksesi në internet

Shkolla aktualisht ka laborator dy laboratorë TIK.

Numri i kompjuterave në laboratorin TIK - 25 dhe 25 kufje
Numri i laptop 50 copë
Printer - 5
Projektor - 7
Laborator i gjuhëve të huaja i paisur me 24 Ipad dhe 24 kufje.

Oborri dhe mjediset sportive

I gjithë territori i shkollës është 4600 m^2 ndërsa vetë godina 2543 m^2.
ka 1 palestër e cila është rikonstruktuar. Në oborrin e jashtëm të saj, shkolla ka një terren sportive edhe ky i rikonstruktuar..

Mobilimi dhe mjete mësimore në klasa

Klasat mësimore janë të mobiluara shumë mirë, me banga dhe karrige dhe ato mirëmbahen me shumë kujdes nga nxënësit nën kujdesin e mësimdhënësit kujdestar.
Gjithashtu në shkollë të gjitha repartet e praktikave profesionale Hoteleri janë të pajisura me mjete pune dhe pajisje të cilat i shërbejnë aftësimit praktik të nxënësve.
Në drejtimin mësimor "Teknologji Ushqimore", është reparti i prodhimit të produkteve të brumit, prodhimit të pijeve dhe përpunimit të fruta perimeve, dhe pjesërisht në punë reparti i përpunimit të qumështit.
Shkolla ofron bazë materiale të konsiderueshme edhe për mësimin teorik.
Sektori i financës kujdeset që shkolla të ketë furnizim ritmik me lëndë të para dhe materiale që i shërbejnë procesit prakti që kryhet në shkollë, por edhe kujdesit për higjienën e pastërtinë në institucion.
Laboratorët, pajisjet, mjetet e punës (për lëndët e përgjithshme dhe lëndë/module profesionale)

Nr	**Ambjenti**	**Sipërfaqe**
1	Biblioteka	50 m^2
2	Laboratori i kimisë	41 m^2
3	Laboratori i analizave	41 m^2
4	Laboratori i biologjisë	41 m^2
5	Laboratori TIK	41 m^2
6	Laborator fizike	41 m^2
7	Qeveria e Nxënësve	41 m^2

Mjedise të përbashkëta - bibloteka

Shkolla është e pajisur me bibliotekë të pasur me 1856 tituj librash dhe tituj tekstesh mësimore të kulturës së përgjithshme të ofruara nga shtëpitë botuese dhe të kulturës profesionale në formën e materialeve mësimore, por kohët e fundit nuk ka patur rinovim apo shtim me tituj të rinj, për mungese fondesh, apo planifikim për tituj nga fondi i Bashkisë Tiranë.

Mjedise për administratën

Mjediset për administratën ndodhen në godinën e dëmtuar nga tërmeti dhe puna e administratës është e vështirë për tu realizuar në kushte normale që prej tre vitesh.
Shkolla ka 8 zyra administrate (1 drejtori, 2 n/drejtori, 1 sekretari, 2 zyrë finance, 1 Njësia zhvillimore, 1 departamentet).

3.2.6 Bashkëpunimi me sektorin privat

a) Numër biznesesh sipas numrit të praktikantëve

Shkolla ka një bashkëpunim shumë të mirë me bizneset e fushës së Hotelerisë dhe të Turizmit si dhe në fushën e furrave të bukës dhe pastiçerisë, kjo e realizuar edhe falë mbështetjes së anëtarëve të Bordit Drejtues. Vitin e fundit *2023-2024* numri i biznesve partnere shkoi rreth 283 ku 90 % e nxënësve në total dhe 100% e nxënësve të drejtimit "Hoteleri Turizëm" dhe "Përpunim brumi", kryen praktika profesionale në biznes
Në fushën e Hotelerisë vlen të theksohet që bizneset partnere janë biznese të njohura kryesisht hotele me 4 dhe 5 yje si dhe restorante shumë cilësore, me një bashkëpunim të qëndrueshëm përgjatë viteve.
Shkolla ka një numër të kondiderueshëm partnerësh ku mund të përmendim:
Fafa
Hotel Mondial
Hotel Hilton Garden Inn Tirana
Melia Durrës Albania
Marriot
Hotel Maritim Plaza
Hotel Rogner
Prestige Resort
Hotel Diplomat
Hotel Kastrati
MK Hotel

Furrë buke – Pastiçeri Durrësi
Le Bon
Restorant Ulliri
Ejsel Catering
Sky Toëer Hotel
Vila 60
Queen Hotel
Furrë buke-Pastiçeri Nela
Furrë buke-Pastiçeri Someg
Hotel Kotoni

Analizë e nxënësve praktikantë në raport me totalin

Numri i nxënësve që kryejnë praktika profesionale gjatë vitit shkollor është i konsiderueshëm, për shkak të profileve që ofron shkolla jonë.
Në drejtimin mësimor "Hoteleri-Turizëm", kryejnë praktika profesionale gjithëvjetore nxënësit e profileve: "Kuzhinë Dual" "Kuzhinë-pastiçeri" (pilot), "Recepsion Dual", "Shërbime në hotel" dhe "Bar Restorant". Risi për këtë vit shkollor ka qenë zbatimi i sistemit dual (arsim i dyfishtë), në të cilin 3 ditë të javës kryhen në biznes dhe 2 ditë në javë zhvillojnë lëndët e kulturës së përgjithshme në shkollë. Gjatë këtyre ditëvë nxënësit monitorohen nga mësimdhënësit e moduleve profesionale sipas profileve. Në drejtimin Hoteleri bashkëpunimi me bizneset është shumë i mirë, jo vetëm për praktika profesionale por edhe për shkëmbime përvojash, për trajnime mësimdhënësish në biznes apo aktivitete të përbashkëta.
Në drejtimin Teknologji Ushqimore, praktika në biznes është zhvilluar me sukses edhe pse ka patur vështirësi për realizimin e e tyre, pasi këto biznese janë më hezituese. Më poshtë tabela me të dhënat e nxënësve që kanë kryer praktika profsieonale në biznese.

Drejtimi mësimor "Hoteleri-Turizëm"

"Hoteleri – Turizëm"	**Nxënës gjithsej**	**Numri i nxënësve praktikantë**	**Përqindja**
Klasa 12 Kuzhinë-Pastiçeri (pilot)	30	30	100%
Klasa 12 Kuzhinë (Dual)	21	21	100%
Klasa 12 Recepsion (Dual)	14	14	100%
Klasa 12 Shërbime në hotel	35	35	100%
Klasa 12 Bar-Restorant	30	30	100%
Klasa 12 Përpunim Brumi	17	17	100%
Totali	**147**	**147**	**100%**

Klasa 10 Kuzhinë EHL	24	24	100%
Klasa 10 Hoteleri EHL	24	24	100%
Klasa 10 Shërbim Ushqim & Pije	15	15	100%
Klasa 10	165	165	100%

Totali	**228**	**228**	**100%**
Klasa 11	172	172	100%
Totali	**172**	**172**	**100%**
Klasa 13	133	24	18%
Totali	133	24	18%
Totali	**680**	**571**	**84%**

Drejtimi mësimor "Teknologji Ushqimore"

"Teknologji Ushqimore"	**Nxënës gjithsej**	**Numri i nxënësve praktikantë**	**Përqindja**
Klasa 12 përpunim brumi	16	16	100%
Klasa 13	33	33	100%
TOTALI për klasat 12 dhe 13	**49**	**49**	**100%**

Klasa 10 dhe 11 teknologji ushqimore ka realizuar edhe vizita në biznese.

3.2.7 Rezulate nga vetëvlerësimi dhe veprimtaria e Njësisë së Zhvillimi

Vlerësimi i institucionit 2025 për vitin akademik 2023-2024 .



Vlerësimi përfundimtar i institucionit 2023-2024

Mbështetur në vlerësimet e pesë fushave, vlerësimi përfundimtar në raport me standardin është:	**1. 5**	**Niveli 2** **Mirë**

Vlerësimi përfundimtar nuk ka ndryshime nga viti shkollor 2022-2023, ngelet në vlerën 1.5, por ka ndryshime midis fushave

Përmbledhje e vetëvlerësimit

Gjatë periudhës Tetor 2024 – Shkurt 2025 u realizua procesi i vetëvlerësimit të institucionit, në 5 fusha, në zbatim të "Udhëzuesit për vetëvlerësimin e IoAFP-ve, në mbështetje të Udhëzimit nr. 18, datë 6.7.2021 për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 16, datë 8.5.2018, "Për zhvillimin e vetëvlerësimit në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional", si edhe kalendari i përcaktuar nga AKAFPK për zhvillimin e procesit të vetëvlerësimit për vitin shkollor 2023-2024. Në përfundim të vetëvlerësimit u realizua analiza sëot e cila do të ndihmojë shkollën në përmirësimin e cilësisë. Për të gjitha pikat e dobëta që kanë dalë nga procesi i vetëvlerësimit janë hartuar rekomandime dhe instrumenta përkatës për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, të cilat janë përfshihrë në planin vjetor 2025-2026.

Njësia e Zhvillimit:

Njësia e zhvillimit funksionon normalisht në shkollën Hoteleri-Turizëm, Tiranë. Puna e Njësisë së Zhvillimit. Në fillim të vitit shkollor u hartua plani vjetor i punës së saj, i cili mori miratimin e drejtuesit të shkollës. Njësia e zhvillimit është mbështetur gjatë veprimtarisë së saj nga Drejtoria e shkollës, që në krijimin e saj dhe funksionon në bazë të Udhëzimit NR. 759 i ndryshuardatë 30.09.2024.

Koordinatorët e saj janë mbështetur në punën e tyre nga AKPA me trajnimesi edhe nga përgjegjësja e njësisë. Vlen të theksohet edhe shkëmbimi i përvojave me shkollat homologe.

Në punën e Njësisë së zhvillimit, gjatë këtij viti janë hasur vështirësi të diktuara disa prej tyre janë të rinje të pa trajnuar.

Krijimi dhe funksionimi i Njësisë së zhvillimit ka punuar për përmirësimin e cilësisë së rezultateve në shkollë dhe intensifikimit të bashkëpunimit me partnerët tanë. Ajo ka shërbyer si një mbështetje e fuqishme në punën për realizimin e objektivave të vitit shkollor, përkrah drejtorisë së shkollës. Disa nga arritjet kryesore të punës së Njësisë së zhvillimit, në përmbushje të qëllimit të saj, për këtë vit shkollor janë:

- Procesi i vetëvlerësimit dhe raporti përfundimtar i vetëvlerësimit është vlerësuar nga ekspertët e AKAFPK si raport shumë cilësor.
- Identifikimi i gjendjes dhe i nevojave, në lidhje me zhvillimin e vazhduar profesional të stafit të mësimdhënësve të shkollës, zhvillimin e kurrikulës, lidhjet me biznesin dhe gjurmimin e nxënësve, projektet shkollore, edukimin për karrierë të nxënësve etj.
- Planifikimi, organizimi, realizimi dhe monitorimi i aktiviteteve të ndryshme në mbështetje të mësimdhënësve dhe nxënësve, në lidhje me zhvillimin profesional, zhvillimin e kurrikulës, lidhjet me biznesin, zbatimin e projekteve, gjurmimin e nxënësve, orientimin për karrierë dhe zhvillimin e marketingut të shkollës.

- Kordinimi i të gjitha palëve të interesit (sektori privat/bizneset/ndërmarrjet, prindërit dhe partnerët e tjerë publikë), jo vetëm për pjesëmarrjen, por edhe për nxitjen e ndikimit të tyre për orientimin e shkollës nga tregu dhe TNNP (Të nxënit nëpërmjet punës).
- Kontributi për garantimin e cilësisë së ofrimit të TNNP në bashkëpunim me drejtuesit dhe stafin e shkollës, nëpërmjet instrumenteve të ndërtuara për këtë qëllim dhe proceseve të mirëmenduara.
- Sistemi dual me dy profile në drejtimin hoteleri-turizëm ka qene një sfidë kryesisht për KMB dhe mbështetjen e mësuesve të praktikës për realizimin sa më korrekt të praktikave profesionale në biznes sipas udhëzimeve. Njësia shkolla dhe mësimdhënësit janë mbështetur nga projekti S4J me trajnime por edhe me sistemimin e nxënësve në praktikë.
- Këtë vit ka qene edhe një sfidë tjetër lidhur me drejtimin VETby EHL në zbatimin e kurrikulës në hartimin e orarit si edhe të gjitjes së vendeve të praktikës për 12 javë sipas programit.
- Promovimi i shkollës "Hoteleri–Turizëm", nëpërmjet kordinimit të zbatimit të planit të zhvillimit të marketingut dhe planit të aktiviteteve
- Kontributi për ta kthyer punësueshmërinë e të diplomuarve, në synimin kryesor të institucionit.

Grupet e interesit dhe partner të brendshëm e të jashtëm.

a. Komuniteti i biznesit

Shkolla e konsideron bashkëpunimin me biznesin si një komponet të rëndësishëm, prandaj ka krijuar lidhje të forta e të qëndrueshme me biznese apo institucione të zonës duke ndarë qëllimet e vlerat dhe duke punuar së bashku me to për të krijuar një mjedis të përgjegjshëm dhe inovativ për përgatitjen e nxënësve për tregun e punës. Aktualisht shkolla ka 212 biznese partnere me Marrëveshje Bashkëpunimi të nënëshkruara dhe gjatë vitit shkollor 2024-2025 kanë realizuar praktikën profesionale në biznes 95% e nxënësve.

b.Komuniteti i prindërve

Bashkëpunimi i shkollës me prindërit mbështetet në Udhëzimit NR. 759 i ndryshuardatë 30.09.2024. Janë të ngritur dhe funksionojnë Këshilli I Prindërve të shkollës dhe Këshillat e Prindërve të klasës. Drejtoria e shkollës bën përpjekje të vazhdueshme për përfshirjen e prindërve në jetën e shkollës. Mësimdhënësit kujdestarë dhe drejtoria e shkollës mban prindërit të informuar për arritjet e nxënësve ,arritjet e shkollës dhe problematikat e ndryshme nëpërmjet takimeve të realizuara me Këshillin e Prindërve dhe takimeve periodike të realizuara nga mësimdhënësit kujdestar me prindërit e klasës.
Gjithashtu shkolla bën përpjekje të vazhdueshme për të bashkëpunuar me prindër të nxënësve të klasës së 9-të duke i ftuar ato në veprimtaritë promovuese që shkolla realizon si psh "Dita e dyerve të Hapura ", por edhe duke i takuar në shkollat 9 vjecare ku fëmijët e tyre studiojnë.

c. Qeveria e nxënësve

Drejtoria e shkollës bashkëpunon me Qeverinë e Nxënësve sipas udhëzimeve në fuqi.

Qeveria e Nxënësve ka përfaqësuesin e saj në Bordin e Shkollës nëpërmjet të cilit mbahet e informuar mbi aktivitetet,veprimtarite,arritjet e nxënësve dhe problematikat e ndryshme dhe gjithashtu është zëri i të gjithë nxënësve për ankesat apo dhe sugjerimet për përmirësimin e shkollës. Drejtoria e shkollës me qëllim matjen e kënaqësisë së nxënësve realizon cdo vit pyetësorë me nxënësit me kamponim dhe gjithashtu ka krijuar këndin e ankesave.

d. Këshilli i mësimdhënësve

Veprimtaria e Këshillit të Mësimdhënësve mbështetet tek legjislacioni në fuqi. Këshilli i mësimdhënësve ka përfaqësuesin e zgjedhur prej tyre ne Bordin e shkollës. Drejtoria e shkollës realizion në mënyrë të vazhdueshme anketa dhe pyetësore më mësimdhënës me qëllim matjen e kënaqësisë së tyre duke evidentuar problematika apo ankesa me qëllim përmirësimin e punës.

e. Bashkia Tiranë

Bashkia Tiranë është një faktor i rëndësishëm i pushtetit vendor, i cili mbështet vazhdimisht shkollën për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për promovimin e shkollës, miratimin e bursave të nxënësve sipas kategorive përfituese, menaxhimin e konviktit dhe mirëmbajtjen e tij duke siguruar kushte komode për akomodimin e tyre.
Shkolla informon Bashkinë për arritjet e nxënësve duke e bërë pjesë të aktiviteteve të ndryshme që realizohen në shkollë dhe jashtë saj sic është “Dita e Dyerve të Hapura”, “Panairi I Praktikave Profesionale” etj.Gjithashtu shkolla merr pjesë në të gjitha aktivitetet ku ftohet nga Bashkia sic janë panairet e ndryshme etj.

f. Zyra Rajonale Vendore e Punës(AKPA Tiranë)

Zyra Rajonale Vendore e Punës mbështet shkollën për orientimin e nxënësve gjatë klasës së 13-të për tregun e punës dhe mundësitë e punësimit si dhe i rregjistron ato si punëkërkues. Gjithashtu kjo drejtori bashkëpunon dhe mbështet shkollën me të dhënat për tregun dhe për promovimin e saj në komunitet. Një përfaqësues nga kjo drejtori është pjesë e Bordit të shkollës.

g. Këshilli i Qarkut Tiranë

Një përfaqësues nga Këshilli i Qarkut Tiranë është anëtar i Bordit të shkollës. Nëpërmjet tij shkolla shpërndan informacion mbi ofertën, bashkëpunimet,arritjet dhe punësimin e nxënësve.

h. Bashkëpunimi me donatorë dhe OJF

Shkolla bashkëpunon me donator, OJF me qëllim sjelljen e finacimeve të nevojshmë për mundësi trajnimi për nxënësit e mësimdhënësit, blerjen e paisjeve të reja etj, me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në shkollë. Shkolla ka bashkëpunuar me OEAD e cila financaur projekte me aspekte gjinore, për përfshirjen e vajzave dhe promovimin e shkollës, gjithashtu ky project ka financuar edhe kabinetin e bar-restorantit.

i.Partnerë të AFP në shkallë kombëtare:
Shkolla ka të identifikuara të gjitha shkollat profesionale të Shqipërisë të cilat ofrojnë të njëjta kualifikime me disa prej të cilave ka krijuar partneritete. Me shkollën e mesme profesionale Kamëz janë zhvilluar projekte Erasmus në kuadër të projektit VET to VET

j.Partnerë të AFP në shkallë kombëtare:

Shkolla ka bashkëpunim edhe me shkolla të AFP-së në nivel ndërkombëtar,bashkëpunime të vendosura në kuadër të projektit Erasmus+ me shkollat: Profesionale Kamës.

k. Zyra Vendore Arsimore dhe Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar

Shkolla bashkëpunon me të dyja institucionet ,por kryesisht me ZVA-Tiranë për:

-Punësimin e mësimdhënësve të lëndëve të përgjithshme nëpërmjet portalit "Mësimdhënës për Shqipërinë".

-Maturën shtetërore.

-Përzgjedhjen dhe shpërndarjen e teksteve për lëndët e kulturës së përgjithshme.

-Lejen për promovimin e shkollës tek nxënësit e klasave të 9-ta

3.3 Analiza swot

Pikat e forta ➢ Zgjerim i dretimeve të shkollës me tre drejtime të shkollës Zviceriane EHL ➢ Ofrimi I sistemir DUAL në profiling Hoteleri Turizëm ➢ Mësimdhënës të trajnuar dhe me përvojë profesionale. ➢ Autorë tekstesh dhe materialesh digjitale. ➢ Reparte praktikash profesionale të pajisura me mjete bashkëkohore (Hoteleri). ➢ Rrjet i gjerë partnerësh biznesi (212), të interesuar për bashkëpunim me shkollën. ➢ Imazh pozitiv i shkollës në komunitet. ➢ Bordi drejtues aktiv dhe mbështetës. ➢ Anëtarësim në Rrjetin Europian të Shkollave të Ekselencës. ➢ Pjesëmarrje në projekte dhe bashkëpunime ndërkombëtare (OeaD, ERASMUS etj.). ➢ Menaxhim efikas i institucionit dhe marketing aktiv. ➢ Aktivitete profesionale të shumta me partnerët. ➢ Trajnime të vazhdueshme të mësimdhënësve dhe drejtuesve. ➢ Mësimdhënës me origjinë nga tregu i punës, me eksperiencë të gjatë. ➢ Pjesëmarrje në projekte ERASMUS për mësimdhënës dhe nxënës. ➢ Mbështetje nga donatorë dhe institucione publike/private. ➢ Përdorimi i teknologjisë digjitale në mësimdhënie dhe administrim.	Pikat e dobëta ➢ Largësia e shkollës nga qendrat e banuara. ➢ Nxënës me rezultate të ulëta nga arsimi 9-vjeçar. ➢ Mungesë laboratorësh virtualë të specializuar ➢ Vështirësi në përfshirjen e prindërve në procesin arsimor. ➢ Numër i konsiderueshëm nxënësish të larguar edhe pse ka një ulje krahasuar me nje vit më parë. ➢ Mungesë e aftësive të buta tek disa nxënës, e konstatuar nga bizneset. ➢ Punësim i ulët për drejtimin e teknologjisë ushqimore; shpesh jashtë profilit.
Mundësitë ➢ Bashkëpunim i zgjeruar me bizneset për trajnimin e nxënësve dhe mësimdhënësve. ➢ Partneritet me institucione të tjera që mund të kontribuojnë për shkollën. ➢ Mësimdhënës trajnerë për kolegë të tjerë.	Sfidat ➢ Rifreskimi i reparteve profesionale me mjete sipas kurrikulës. ➢ Shfrytëzimi i konviktit si Hotel Mësimor për nxënësit. ➢ Kthimi i shkollës në një qendër të madhe trajnimesh dhe qendër komunitare.

➢ Praktika profesionale të realizuara me sukses në bashkëpunim me bizneset. ➢ Histori suksesi të ish-nxënësve si model frymëzues. ➢ Projekte të përbashkëta me sektorin privat: orë mësimore, vizita studimore, trajnime. ➢ Përdorimi i fondeve të BE dhe donatorëve për modernizimin e infrastrukturës. ➢ Përfshirja në programe rajonale dhe kombëtare të zhvillimit profesional. ➢ Zhvillimi i kurseve të shkurtra profesionale për komunitetin dhe bizneset lokale. ➢ Hapja e shkolës pas të mesme në të dy drejtimet.	➢ Rreziku nga fatkeqësi natyrore dhe epidemi. ➢ Mungesa e akteve nënligjore për vetëfinancimin e shkollave profesionale. ➢ Ulja e numrit të nxënësve që përfundojnë klasën e 9-të. ➢ Përqindje e lartë nxënësish nga kontekste sociale vulnerabël. ➢ Emigrimi i të rinjve dhe mungesa e motivimit për arsimin profesional. ➢ Mësimdhënës të rinj me nevojë për trajnim të vazhduar.

Vizioni, Misioni, Ambicia, Vlerat dhe Kompetencat Dallues

Vizioni

Të përgatisim punonjës të kualifikuar në industrinë e mikpritjes dhe ushqimit, duke ofruar alternativa profesionale cilësore, inovative dhe konkurruese, në partneritet të ngushtë me bizneset relevante, për integrimin e shpejtë dhe të denjë të nxënësve në tregun e punës.

Misioni

Të fuqizojmë rritjen profesionale e personale të nxënësve, duke ushqyer ekselencën në përvojën njerëzore, me synim përgatitjen e profesionistëve të aftë dhe qytetarëve të denjë për shoqërinë.

Ambicia

Të krijojmë një rrjet ekselence në arsim dhe partneritete biznesi, që do të ndikojë në zhvillimin e industrisë së mikpritjes dhe ushqimit në Shqipëri dhe më gjerë. Ne besojmë se duke rritur cilësinë e arsimit profesional dhe duke forcuar lidhjen midis shkollës, industrisë dhe komunitetit, kontribuojmë në suksesin e qëndrueshëm të industrisë dhe në një ndikim pozitiv shoqëror.

Vlerat

• **Bashkëpunimi:** Ne besojmë në fuqinë e punës së përbashkët me nxënësit, prindërit, partnerët dhe biznesin.

• **Gjithëpërfshirja:** Ne ofrojmë mundësi të barabarta për të gjithë, pa dallim.

• **Inovacioni:** Ne nxisim krijimtarinë, mendimin kritik dhe përdorimin e teknologjive bashkëkohore.

• **Mjedisi miqësor:** Ne ofrojmë një hapësirë të sigurt, të ngrohtë dhe motivuese për nxënësit.

• **Profesionalizmi:** Ne përgatitim nxënës me standarde të larta profesionale, të vlerësuar në tregun e punës kombëtar dhe europian.

• **Transparenca:** Ne ndërtojmë besim përmes komunikimit të hapur dhe të ndershëm.

• **Partneritetet:** Ne bashkëpunojmë ngushtë me industrinë dhe organizatat vendase e ndërkombëtare.

• **Integriteti:** Ne veprojmë me ndershmëri dhe përgjegjësi në çdo hap.

Kompetencat dalluese

• Jemi shkolla e parë e Hoteleri–Turizmit në Shqipëri, e ngritur me mbështetjen e partnerëve austriakë përmes projekteve të Qeverisë Austriake dhe Zyrës për Arsim në Shqipëri, K-Kontakt.

• Jemi shkolla me imazhin më të mirë në fushën e Hoteleri–Turizmit, e vlerësuar nga bizneset dhe donatorët ndërkombëtarë që mbështesin arsimin profesional.

• Ofrimi i praktikave profesionale në ambiente bashkëkohore brenda shkollës dhe në biznese të industrisë, me më shumë se 50% të orëve të kurrikulës të zhvilluara në vendin e punës.

• Mësimdhënës profesionistë dhe ekspertë të njohur të fushës, autorë materialesh mësimore dhe pjesë e grupeve kombëtare për hartimin e kurrikulave.

• Histori suksesi me ish-nxënësit tanë janë menaxherë, sipërmarrës dhe profesionistë të denjë në tregun kombëtar dhe europian të punës, me diploma të njohura ndërkombëtarisht.

• Bashkëpunim i ngushtë me shkollën zviceriane EHL, duke ofruar tre drejtime Vet by EHL.

• Vlerësuar nga ETF si shkollë ekselence për të nxënët në vendin e punës.

• Numri i madh i bizneseve që i drejtohen shkollës për punonjës të kualifikuar është tregues i drejtpërdrejtë i cilësisë sonë.

b) Prioritetet, objektivat strategjike dhe treguesit e aritjeve/ performances

5.PRIORITETET,OBJEKTIVAT STRATEGJIKË DHE TREGUESIT E ARRITJEVE/PERFORMANCËS

Prioritete	Objektiva afatmesme	Tregues performance	Objektiva Vjetore	Tregues performance
1.Oferta arsimore sipas kërkesës së tregut të punës që sigurojnë të nxënët gjatë gjithë jetës	1.1 Vlerësim periodik i nevojave të tregut	1.1Numri i tryezave të dialogut të realizuara në vit 1.2 Numri i bizneseve pjesëmarrëse	1.1.1 Vlerësim periodik i nevojave të tregut	1.1.1.Numri i tryezave të dialogut të realizuara gjatë vitit shkollor 2025-2026 të realizohet të paktën 1 tryezë. 1.1.2 Numri i bizneseve pjesëmarrëse
	1.2Infrastrukturë bashkëkohore për të gjitha kualifikimet aktuale dhe të reja.	1.2 Numri i paisjeve/laboratoreve të reja	1.2.1 Infrastrukturë bashkëkohore për të gjitha kualifikimet aktuale dhe të reja.	1.2.1 Numri i paisjeve/laboratoreve të reja
	1,3 Hapja e një kualifikimi të nivelit të V KSHK-së, bashkëkohore për të dyja drejtimet	1.3 Numri i kualifikimit të nivelit të V të KSHK-së	1.3.1 Hapja e kualifikimit të V KSHK-së në drejtimin Hoteleri-Turizëm	1.3.1 Hapja e një kualifikimit të V të KSHK-së në drejtimin Hoteleri-Turizëm
	1.4 Ritje profesionlae e mësimdhënësve nga shkolla dhe biznesi	1.4 Të gjithë mësimdhënësit që japin mësim në kualifikimet të trajnohen nga shkolla dhe biznesi	1.4.1 Ritje profesionlae e mësimdhënësve nga shkolla dhe biznesi	1.4.1 Të gjithë mësimdhënësit që japin mësim në kualifikimet të trajnohen nga shkolla dhe biznesi
2.Përmirësimi i të nxënit në vendin e punës	2.1 Përzgjedhja e biznesese për realizimin e praktikave profesionale në përputhje me	2.1Numri i bizneseve të përzgjedhura me të gjitha postet e punës	2.1.1. Realizimi i praktikat në biznes duke zbatuar 100% udhëzimin e praktikave në të dy drejtimet për të gjitha kualifikimet	2.1.1. Realizimi i praktikave në biznes në sipas udhëzime për të dy drejtimet Teknologji ushqimore dhe Hoteleri-turizëm.

	kompetencat e kërkuara		2.1.2 Realizimi i praktikave në bisnes për të gjithë kualifikimet e sistemit VET by EHL	2.1.2 Realizimi në masën 100 % praktika 12 javore për të gjithë kualifikimet e sistemit VET by EHL
			2.1.3 Ritja e numrit të nxënësve të punësuar në tregun e punës krakasuar me një vit më parë.	2.1.3 Përqindja e nxënësve të punësuar kundrejt totalit.
	2.2 Përfshirja në kurrikulën në bazë shkolle e "Aftësive të Buta, digjitale dhe të gjelbëra."	2.2 Të gjitha kurrikulat e hartuara në shkollë për kulturën profesionale kanë të përfshirë edhe "Aftësitë e Buta, digjitale dhe të gjelbra"	2.2.1 Përfshirja në kurrikulën në bazë shkolle e aftësive ndërkurrikulare, të gjelbra, digjitale si edhe të zhvillimit të qëndrueshëm.	2.2 Të gjitha kurrikulat e hartuara në shkollë kanë të përfshirë aftësitë ndërkurrikulare, të gjelbra, digjitale si edhe të zhvillimit të qëndrueshëm.
	2.3 Ngritja e strukturave të brëndshme për monitorimin dhe garantimin e cilësisë	2.3Të gjithë anëtarët e strukturave të brëndshme kapacitohen për monitorimin dhe garantimin e cilësisë	Objektivi 2.3.1 Kapacitimi i strukturave të brëndshme për monitorimin dhe garantimin e cilësisë	2.3.1 Të gjithë anëtarët e strukturave të brëndshme kapacitohen për monitorimin dhe garantimin e cilësisë
	2.4 Trajnim i mentorëve të bizneseve	2.4.Trajnimi i të pakten 80% të mentorëve të bizneseve	Objektivi 2.4.1 Trajnim i mentorëve të bizneseve	2.4.1 Trajnimi i të pakten 80% të mentorëve të bizneseve
3.Mësimdhëni e inovative	3.1Kapacitimi i të gjithë mësimdhënësve për pedagogjinë digjitale dhe përdorimin e	3.1Të gjithë mësimdhënësit e lëndëve profesionale kapacitohen për pedagogjinë digjitale për	3.1.1Përmirësimi i cilësia e mësimdhënies duke përdorur metoda inovative dhe teknologji digjitale në mësimdhënie	3.1.1.Përqindja e mësimdhënësve që përdorin metoda inovative dhe teknologji digjitale në mësimdhënie.

	materialeve mësimore digjitale	përdorimin e materialeve mësimore digjitale	Objektivi 3.1.2 Kapacitimi i të gjithë mësimdhënësve për pedagogjinë digjitale për përdorimin e materialeve mësimore digjitale	3.1.2Përqindja e mësimdhënësve që përdorin materiale mësimore digjitale.
	3.2Kurrikula të përditësuara	3.2 Të gjitha planet lëndore dhe programet e moduleve të praktikave profesionale rishikohen duke përfshirë përdorimin e teknologjisë dhe metodat inovative të mësimdhënies	3.2.1 Përditësimi i kurrikulës shkollore sipas udhëzimeve të fillimvitit dhe bazës ligjore në fuqi.	3.2.1 Të gjitha planet lëndore dhe programet e moduleve të praktikave profesionale rishikohen duke përfshirë përdorimin e teknologjisë DIGJITALE dhe metodat inovative të mësimdhënies

KALENDARI I VEPRIMTARIVE KRYESORE, MONITORIMI E BUXHETIMI

Objektivi vjetor 1.1.1 Vlerësim periodik i nevojave të tregut							
Veprimtaritë	Tregues performance	Afate	Njësia/personi përgjegjës	Njësia/personi monitorues	Frekuenca e raportimit	Dokumenti vlerësues	Buxheti i planifikuar
Tryeza dialogu me bizneset partnere dhe biznese të tjera	Një tryezë dialogu për të dy drejtimet	Janar 2026	Njësia e Zhvillimit	Drejtoria	Gjatë vitit	Listë-prezenca Raporte	Shkolla
Tryeza dialogu me institucionet lokale	Realizohen i tryeza dialogu	Shkurt 2026	Njësia e Zhvillimit	Drejtoria	Gjatë vitit	Listë-prezenca Raporte	Shkolla
Tryeza dialogu me komunitetin	Realizohet i tryezë dialogu	Mars 2026	Njësia e Zhvillimit	Drejtoria	Gjatë vitit	Listë-prezenca Raporte	Shkolla
Gjurmimi i të diplomuarave	Gjurmohën ish maturantët e diplomuar një vit më parë.	Janar 2026	Njësia e Zhvillimit	Drejtoria	Gjatë vitit	Listë-prezenca Raporte	Shkolla

Objektivi vjetor 1.2.1. Infrastrukturë bashkëkohore për të gjitha kualifikimet egzistuese dhe të reja							
Veprimtaritë	Indikatori	Afati	Njësia/personi përgjegjës	Njësia /personi monitorues	Frekuenca e raportimit	Dokumenti vlerësues	Buxheti i planifikuar
Vënia në funksion e repartit të qumështit	Repart funksional në përgjigje të kërkesave të kurrikulës	Shtator- Maj 2026	Departamenti Drejtoria	Drejtoria	Në fund të vitit	Marrja në dorëzim	Buxheti i planifikuar
Rritja e numrit të klasave me projektorë dhe teknologji digjitale	Kabinete funksional në përgjigje të kërkesave të kurrikulës	Shtator- Maj 2026	Drejtoria	Drejtoria	Në fund të vitit	Marrja në dorëzim	Buxheti i planifikuar
Mirëmbajtja dhe pasurimi i laboratorëve	Laboratorë funksionalë në përgjigje të kërkesave të kurrikulës	Gjatë vitit	Departamentet Drejtoria	Drejtoria	1 herë në gjashtë muaj	Fatura shërbimi dhe blerje	Shkolla

Objektivi 1.3.1 Hapja e kualifikimit të V KSHK-së në drejtimin Hoteleri-Turizëm.							
